




Republika e Kosovës

Republic of Kosovo

Republika Kosova



Komuna Skenderaj

Municipality of Skenderaj

Opštine Skenderaj

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

Directorate for Geodesy, Cadastre and Property

Direkcija za Geodeziju, Kadastar i Imovinu

Plani i punës për vitin 2026

Më qëllim të realizimit sa më efikas të detyrave dhe përgjegjësiave tona, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë bën përpilimin e Planit të Punës për vitin 2026.

Misioni i Drejtorisë

Misioni primar i Drejtorisë është ofrimi i shërbimeve sa më profesionale dhe efikase!

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë (referuar në vijim si DGJKP) është përgjegjëse për organizimin e kapaciteteve kadastrale në formë digjitale, modelin e sistemit informativ mbi pronën në përgjithësi, planifikimin e rrjetit gjeodezik me pika të reja kontrolluese dhe themelimin e pikave të reja kontrolluese.

DGJKP procedon shfrytëzimin e pronave komunale, zbaton vendimet e gjykatave, aktet noteriale dhe aktet e tjera që dalin nga organe apo individë të licensuar nga organet shtetërore, që kanë të bëjnë me bartjen, bashkimin apo ndarjen e pronës.

Puna e Drejtorisë orientohet në atë mënyrë që, përmes matjeve kadastrale, sistemit informativ të tokave (SIKT) dhe regjistrave zyrtar të siguroj të drejtat mbi pronat e paluajtshme mbi krijimin e parcelave tokësore, ndërtesave si dhe përcaktimin e kufijve të tyre brenda territorit të Komunës së Skënderajt.

DGJKP bashkëpunon ngushtë me institucionet lokale dhe qendrore, siç janë Drejtoritë Komunale, Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrinë e Financave si dhe me Agjencinë Kadastrale të Kosovës (referuar në vijim si AKK) si autoritet qendror i menaxhimit të të dhënave kadastrale.

DGJKP ka para vetës objektivat në parim të realizueshme, të cilat synon ti arrijë me profesionalizëm dhe korrektësi në përputhje me dispozitat ligjore në bazë të cilave punon dhe vepron.

Sektorët

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë është e organizuar në sektorët si vijon:

- **Spektori i Gjeodezisë**
- **Spektori i Kadastrit**
- **Spektori i Pronës**

Spektori i Gjeodezisë

Spektori i Gjeodezisë është përgjegjës për:

- Përpunimin dhe regjistrimin e të dhënave në grafikë,
- Identifikimin e ngastrave dhe njësive kadastrale në sistemin e hartave,
- Ndarjen dhe bashkimin e ngastrave kadastrale, të proceduara nga kërkesa e palëve,
- Përpunimin e skicave të ndarjes,
- Azhurimin e pjesës grafike në bazë të dokumenteve dhe matjeve të reja dhe transformimin me parametrat e dhëna për transformim,
- Kryerjen e shërbimeve për shënimet e digjitalizuara (dhënien e koordinatave për teren),
- Kryerjen e shërbimeve për shënimet e digjitalizuara të njohura si Kopje të Planit,
- Kryerjen e shërbimeve për shënimet e digjitalizuara për lartësinë mbidetare të pronës,
- Përkrahjen dhe ofrimin e ndihmes komisioneve të formuara nga Agjencia Kadastrale e Kosovës,
- Rindërtimin e Zonave Kadastrale të Komunës së Skënderajt në bashkëpunim me Agjencinë Kadastrale të Kosovës,
- Kryen shërbime të tjera të parapara me ligj dhe rregullore.

Sektori i Kadastrit

Sektori i Kadastrit është përgjegjës për:

- *Regjistrimin e pronave të paluajtshme në Regjistrin e të Drejtave të Pronave të Paluajtshme (RDPP),*
- *Pararegjistrimin dhe regjistrimin e objekteve ndërtimore në pajtim me ligjin përkatës për ndërtim,*
- *Korigjimin e të dhënave në Regjistrin e të Drejtave të Pronave të Paluajtshme (RDPP), sipas procedurave ligjore në fuqi,*
- *Identifikimin e njësive kadastrale,*
- *Modifikimin, ndarjen dhe bashkimin e njësive kadastrale, në pjesën tekstuale, të proceduara nga kërkesa e palëve,*
- *Azhurimin e pjesës tekstuale në bazë të dokumentacionit dhe matjeve të reja dhe transformimin me parametrat e dhëna për transformim,*
- *Kryerjen e shërbimeve për shënimet e digjitalizuara të njohura si çertifikata të pronës, që dëshmojnë pronësinë apo posedimin mbi paluajtshmëritë,*
- *Azhuron ndryshimet në RDPP në bazë të akteve juridike siç janë aktvendimet e gjykatave, aktet noteriale dhe aktet e tjera që dalin nga organe apo individë të licensuar nga organet shtetërore,*
- *Regjistrimin , modifikimin dhe fshirjen e hipotekave, barrave tatimore dhe ngarkesave tjera sipas sistemit për menaxhimin e lëndëve,*
- *Çregjistrimin e ndërtesës së rrënuar të cilat kanë qenë të pajisura me leje ndërtimore,*
- *Nxjerrë aktvendime dhe konkluzione lidhur me kërkesat e palëve,*
- *Përkrahjen dhe ofrimin e ndihmes komisioneve të formuara nga Agjencia Kadastrale e Kosovës,*
- *Koordinon punët me Agjencinë Kadastrale të Kosovës, duke zbatuar kështu edhe udhëzimet dhe rekomandimet që dalin nga monitorimi vjetor që kryhet po ashtu nga Agjencia Kadastrale i Kosovës,*
- *Kryen shërbime të tjera të parapara me ligj dhe rregullore.*

Objektivat e Sektorit të Kadastrit

Nr.	Objektivat	Procedura	Burimi	Mbikqyrësi	Zbatuesi
1.	Bartja dhe regjistrimi i të drejtave të pronave të paluajtshme në RDPP, sipas akteve juridike	E rregullt	Legjislacioni në fuqi	Agjencia Kadastrale e Kosovës	DGJKP
2.	Regjistrimi i ndërrimeve kadastrale në SIKTK	E rregullt	Legjislacioni në fuqi	Agjencia Kadastrale e Kosovës	DGJKP
3.	Regjistrimi i kadastrit etazhor në SIKTK	E rregullt	Legjislacioni në fuqi	Agjencia Kadastrale e Kosovës	DGJKP
4.	Harmonizimi i të dhënave grafike me ato tekstuale	E rregullt	Legjislacioni në fuqi	Agjencia Kadastrale e Kosovës	DGJKP
5.	Regjistrimi i hipotekave dhe ngarkesave tjera në SIKTK	E rregullt	Legjislacioni në fuqi	Agjencia Kadastrale e Kosovës	DGJKP
6.	Azhurimi i procesit të legalizimit të ndërtesave në kadastër	E rregullt	Legjislacioni në fuqi	Agjencia Kadastrale e Kosovës	DGJKP
7.	Modifikimi i të dhënave në Kadastër	E rregullt	Legjislacioni në fuqi	Agjencia Kadastrale e Kosovës	DGJKP
8.	Azhurimi i dokumentacionit kadastral	E rregullt	Legjislacioni në fuqi	Agjencia Kadastrale e Kosovës	DGJKP
9.	Shërbime të tjera				DGJKP

Sektori i Pronës

Sektori i Pronës është përgjegjës për:

- *Menaxhimin e pronës komunale,*
- *Mbajtjen e evidencës për token dhe objektet komunale,*
- *Zhvillon procedurat administrative sipas detyrës zyrtare për ruajtjen e pronës komunale,*
- *Identifikimin e të gjithë uzurpatorëve të pronës komunale,*
- *Njoftimin, inicimin dhe zhvillimin e procedurave lidhur me uzurpimet,*
- *Udhëheqë procedurat ligjore për dhënien në shfrytëzim të pronës publike Komunale në interesin publik të Komunës,*
- *Inicimin e procedurave lidhur me këmbim të pronës,*
- *Inicimin e procedurave të nevojshme administrative,*
- *Kryerjen e punëve të tjera që janë në kuadër të drejtorisë në bazë të legjislacionit në fuqi.*

Objektivat e Sektorit të Pronës

<i>Nr.</i>	<i>Objektivat</i>	<i>Procedura</i>	<i>Burimi</i>	<i>Mbikqyrësi</i>	<i>Zbatuesi</i>
1.	<i>Shpronësimi</i>	<i>E rregullt</i>	<i>Legjislacioni në Fuqi Vendimi i Kuvendit Komunal</i>	<i>Kryetari i Komunës Kuvendi Komunal</i>	<i>DGJKP</i>
2.	<i>Verifikimi dhe procedimi për lirim të pronave të uzurpuara (nëse ka)</i>	<i>E rregullt</i>	<i>Legjislacioni në fuqi Vendimi i Organit Administrativ Komunal</i>	<i>Kryetari i Komunës DGJKP</i>	<i>DGJKP</i>
3.	<i>Inkasimi i të hyrave të qerasë dhe rentës</i>	<i>E rregullt</i>	<i>Legjislacioni në fuqi Rregullorja e brendshme e Komunës</i>	<i>Kryetari i Komunës DGJKP</i>	<i>DGJKP</i>
4.	<i>Arkivimi i dokumentacioni kadastral</i>	<i>E rregullt</i>	<i>Legjislacioni në fuqi</i>	<i>DGJKP</i>	<i>DGJKP</i>
5.	<i>Mbikëqyrja e kontratave mbi shfrytëzimin e pronave publike</i>	<i>E rregullt</i>	<i>Legjislacioni në fuqi</i>	<i>Kryetari i Komunës Kuvendi Komunal</i>	<i>DGJKP</i>
6.	<i>Shërbime të tjera</i>				

Përfundim

Zyra Kadastrale Komunale (ZKK) përkohësisht vepron në kuadër të Institucionit të Komunës së Skenderajt pasi që me LIGJIN NR.08/L-237 PËR KADASTËR TË PRONËS SË PALUAJTSHME dhe plotësim ndryshimin e ligjit për financa të pushtetit lokal ZKK-të parashihet të kalojnë nën menaxhimin e Agjencisë Kadastrale të Kosovës.

Plani i punës i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë është një përmbledhje e përgjithshme e veprimeve dhe aktiviteteve që do të ndërmerrën në funksion të arritjes së objektivave që parashihet ti kemi para vetës në vitin 2026.

Përmes planit të punës për vitin 2026, përkatësisht objektivave të këtij plani, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë synon përmirësimin dhe digjitalizimin e shërbimeve kadastrale, përmirësimin e shërbimeve gjeodezike, menaxhimin efikas të pronës publike, menaxhimin efikas të Regjistrit të Paluajtshmërive etj.

Këto objektivat synojmë ti arrijmë me profesionalizëm, transparencë dhe llogaridhënie!

Skenderaj, 18.12.2025




Kreshnik Smakiqi

Drejtorja për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë